

## Ilir Hoxha nuk lejohet të hyjë në shtëpinë e të atit

Oct 16 2008

Posted by Revolucion in *PRO & KUNDER, VENDI SOT*



**INTERVISTA/ Ilir Hoxha shprehet se kërkonte t'iu jepte nga një gotë raki e karamelë gjithë shqiptarëve**

**GJIROKASTËR-** Megjithëse e planifikuar prej disa kohësh, ceremonia e 100-vjetorit të Enver Hoxhës në qytetin e tij Gjirokastrë është zhvilluar jashtë shtëpisë së lindjes. Djali i tij, Ilir Hoxha, me bashkëshorten dhe të gjithë pjesëmarrësit nuk janë lejuar të hyjnë në godinën që tashmë është muze etnografik, edhe pse leja për ta përdorur për një ditë për ceremoni private ishte dhënë nga kryebashkiaku Flamur Bime rreth një muaj më parë.

Ndërsa është detyruar që përkujtimin e babait të tij ta zhvillojë përpara shtëpisë bashkë me dhjetëra të ardhur jo vetëm nga qytetet shqiptare, Ilir Hoxha ka shprehur keqardhjen për këtë vendim. Në një intervistë për "Shekulli"-n ai rrëfen adhurimin për babanë dhe veprën e tij, ardhjen dhe pamundësinë e kryerjes së ceremonisë ashtu si ishte menduar, mesazhet e ardhura në këtë 100-vjetor nga të gjitha anët e kombit etj.

Jeni rikthyer në Gjirokastrë. Çfarë simbolizon ardhja e sotme?

- Unë vij shpesh në qytetin e lindjes së babait tim, qytet që ai e desh shumë. Por sot është një ditë e veçantë, pasi kam një detyrim ndaj qytetarëve të Gjirokastrës dhe jam këtu për ta përmbushur atë.

Ceremonia po organizohet në ambientet e jashtme, dhe jo siç ishte planifikuar. Përse?

- Kisha dëshirë që në këtë 100-vjetor, në shtëpinë ku u lind im atë, të takoja gjirokastritët, t'iu jepja një gotë raki e një karamelë dhe të bisedoja me ta. Kjo ishte dëshira ime, dhe ndaj u drejtova dhe mora edhe lejen. Por sot nuk na kanë lejuar, e

kanë quajtur këtë ceremoni si dhunim të institucioneve. Por familja e Enver Hoxhës asnjëherë nuk dhunon, ajo vetëm respekton.

Ndiheni i fyer nga ky fakt?

- Jo aspak. Thjesht më vjen keq.

Ju dhe bashkëshortja juaj jeni të vetmit të ardhur nga familja Hoxha në ceremoninë e organizuar. Po përsa u përket anëtarëve të tjerë?

- Unë jam këtu si përfaqësues i familjes së Enver Hoxhës.

Kohët e fundit daljet tuaja dhe të disa anëtarëve të tjerë të familjes suaj kanë qenë të shpeshta. Janë të rastësishme?

- Ne gjithmonë kështu kemi qenë aktivë, dhe jo vetëm në media. Por kur ky shtet na pengon, ne bëjmë thjesht detyrën tonë. Ky është fakti për të cilin mediat na fokusojnë shpesh.

Sot, në këtë ceremoni, ka të ardhur edhe nga viset e tjera jashtë Shqipërisë. Si e vlerësoni këtë fakt?

- Enver Hoxha është një figurë jo vetëm e Shqipërisë, por e të gjithë kombit shqiptar. Para disa ditësh isha në Kosovë në një ceremoni shumë të bukur kushtuar babait tim, ku u ngritën lart vlerat e këtij njeriu që ka bërë shumë për shqiptarët jashtë territorit administrativ, për minoritetet, kosovarët, çamët. Jo vetëm ka punuar, por ka pasur strategji dhe platforma të sakta për këto çështje. Vlerësime kanë ardhur nga të gjitha anët e botës: nga Amerika, Kanadaja, Zvicra, Italia etj. Na kanë mbërritur mesazhe që, përveç vlerësimit, kërkojnë që të vihet një kurorë nga ata në pamundësi për të qenë të pranishëm. Natyrisht, i vlerësoj shumë të gjitha këto fakte.

Gjatë këtyre viteve të fundit, figura e Enver Hoxhës është sulmuar shumë. Ju si djali i tij ndiheni në njëfarë mënyre të persekutuar?

- Jo. Unë natyrisht që jam në krahun e babait tim dhe do ta mbroj atë dhe kujtimin e tij në çdo moment e çdo situatë, pavarësisht gjithçkaje që mund të thonë apo deklarojnë. Por, vepra e e babait tim vazhdon të jetë e dukshme.

Cili është kujtimi më i bukur që keni me babanë tuaj?

- Kujtimet e bukura janë të shumta dhe nuk mund të veçoj asnjërën prej tyre. Ai ka qenë një prind i shkëlqyer e më tej një gjysh po aq i përkryer. Na ka mësuar të duam atdheun, popullin, të gjithë shqiptarët.